

ANGAZHIMI PËR VEPRIM TË PËRBASHKËT - EJA KOSOVË

UDHËZUESI PËR PROCEDURËN E NOMINIMIT PËR ÇMIMIN PËR DEMOKRACI

HYRJE

Angazhimi për Veprim të Përbashkët (EJA Kosovë) është program i KCSF-së që mbështet nismat e shoqërisë civile përmes granteve, Çmimit për demokraci dhe ndërtimit të kapaciteteve me synimin e përgjithshëm për t'i kontribuar një shoqërie demokratike e gjithëpërfshirëse në Kosovë në rrugën e saj drejt integritit në Bashkimin Evropian. E themeluar si mekanizëm i financimit ku disa donatorë i bashkojnë fondet e tyre për përkrahjen e shoqërisë civile, EJA Kosovë aktualisht financohet bashkërisht nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) Suedia dhe Qeveria e Dukatit të madh të Luksemburgut.

Duke vënë në plan të parë angazhimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve përgjatë tërë punës së shoqërisë civile, EJA Kosovë synon të kontribuojë drejt dy qëllimeve kryesore ku: (a) shoqëria civile shfrytëzon hapësirat për avokim dhe synon krijimin e mundësive/hapësirave të reja për pjesëmarrje të qytetarëve dhe qytetarëve në formësimin e çështjeve me interes publik dhe (b) organizatat e shoqërisë civile forcojnë lidhjet me qytetarë dhe përmirësojnë llogaridhënien dhe transparencën ndaj anëtarëve dhe publikut të gjerë.

EJA Kosovë bazohet në premisën që përmes sistemeve të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe llogaridhënies nga njëra anë, dhe qasjes dhe komunikimit më të mirë me komunitetin, nga ana tjetër, OSHC-të do ta përbrendësojnë praktikën e përfshirjes së qytetarëve në punën e tyre dhe do të zhvillojnë një bashkëpunim më të thellë duke i kontribuar kështu drejtpërdrejt forcimit të lidhjes me grupet e qytetarëve për të cilët angazhohen. E kombinuar me qeverisje të brendshme më të mirë dhe transparencë e llogaridhënie të shtuar, EJA Kosovë pritet të rrisë besimin në shoqërinë civile si një platformë e përshtatshme për t'i shprehur shqetësimet e qytetarëve.

Kosova vazhdon të përballet me shumë vështirësi socio-ekonomike, me papunësi të lartë, gjendje ekonomike të rënduar, nivele të larta të korrupsionit dhe mos-besim në institucione publike. Gratë, rinia, pakicat nga komunitetet Rom, Ashkali e Egjiptian si dhe Serb, personat me nevoja të veçanta, komuniteti LGBTI dhe të moshuarit janë më të prekurit nga këto vështirësi. Roli i shoqërisë civile është që t'iu shërbej këtyre grupeve, por poashtu edhe të bëj kërkesa dhe kërkoj llogari për përgjigje institucionale për nevojat e tyre. Ngjashëm, shoqëria civile e ka të domosdoshme për të përforcuar lidhjet me qytetarët, për të ndërtuar besim dhe komunikim me komunitetin dhe për të vepruar si mbikqyrës të institucioneve. Përhapja në nivel global e COVID-19 dhe efektet e kësaj pandemie kanë ekspozuar edhe më tej të pabarazinë në shoqërinë tonë, duke ndikuar në mënyrë joproporcionale në grupet më të marginalizuara. Pabarazitë tashmë ekzistuese në shoqërinë tonë do të bëhen edhe më të thella nëse grupet e marginalizuara nuk sillen në qendër të vëmendjes gjatë fazës së rimëkëmbjes. Është e nevojshme që shoqëria civile të mobilizohet dhe t'iu jap zë atyre që iu duhet më së shumti në këtë kohë.

Instrumentet mbështetëse të EJA Kosovë

EJA Kosovë është dizajnuar me qëllimin për ta lehtësuar dhe mbështetur në mënyrë adekuate këtë qasje të re, përmes sigurimit të mjeteve të nevojshme financiare dhe kapaciteteve të nevojshme për iniciativat e shoqërisë civile dhe individët e interesuar për t'i kontribuar një shoqërie demokratike e gjithëpërfshirëse në Kosovë. Përmes *granteve institucionale*, EJA Kosovë do të mbështesë organizata të konsoliduara që kanë strategji të qartë për ta vazhduar punën e tyre në fushat përkatëse tematike; përmes *granteve për zhvillim organizativ*, EJA do t'i mbështesë organizatat që kanë drejtim të qartë të zhvillimit, por që kanë nevojë për mjete dhe burime specifike për ta avancuar punën e tyre; përmes *granteve për projekte*, do të mbështesë veprime specifike të nismave të shoqërisë civile dhe individëve që adresojnë çështje konkrete, qoftë të një natyre më sistematike ose më të kufizuar në shtrirje dhe kohëzgjatje; përmes *granteve urgjente*, EJA do të mundësojë reagime të menjëhershme të nismave të shoqërisë civile dhe individëve ndaj zhvillimeve të papritura të rëndësisë publike; dhe përmes *Çmimit për Demokraci që ndahet në baza vjetore*, do të njohë kontributet e jashtëzakonshme për zhvillimin e demokracisë në Kosovë dhe do të promovojë rastet dhe modelet që duhet ndjekur. Trajnimi dhe mentorimi, si dhe mundësitë për rrjetëzim dhe ndërtim të aleancave do të ofrohen si mundësi shtesë përveç mbështetjes financiare.

Çmimi për Demokraci

Çmimi për Demokraci ka për qëllim të vlerësojë kontributet e individëve, nismave të paregjistruara dhe të organizatave jo-qeveritare në fusha të ndryshme, që janë rezultat i mobilizimit të komunitetit dhe angazhimit të qytetarëve, guximit intelektual ose arritjeve të theksuara, dhe që kanë kontribuar në demokratizimin e shoqërisë kosovare përmes punës dhe përkushtimit të tyre.

Kriteret për nominim

Kush mund të nominohet?

Të drejtën për t'u nominuar e kanë të gjitha organizatat jo-qeveritare, nismat e paregjistruara dhe individët të cilët me punën dhe përkushtimin e tyre kanë dhënë kontribut në demokratizimin e shoqërisë kosovare.

Të nominuarit nuk duhet të jenë/të udhëhequr nga Persona të Ekzpozuar Politikisht (PEP)¹.

Përfitues të Çmimit për Demokraci nuk mund të jenë:

- a) Organizatat/nismat/individët të cilët për kauza të njëjta janë përkrahur financiarisht nga KCSF gjatë tri viteve të fundit (2019, 2020, 2021)
- b) Nismat e njëjta ose shumë të ngjashme me ato të cilat janë shpërblyer me Çmimin për Demokraci gjatë tri viteve të fundit (2019, 2020, 2021)

¹ Për më shumë rreth kufizimeve në lidhje me personat e ekspozuar politikisht (PEP), shih formularin për nominim.

Kush mund të nominojë?

Nominimet mund t'i paraqesë cilado organizatë, subjekt apo person që ka informata të sakta dhe të detajuara mbi *nismën* e nominuar. Të interesuarit mund të nominojnë edhe vetveten.

Kriteret e përzgjedhjes

Të gjitha nominimet do të shqyrtohen veç e veç dhe do të vlerësohen nga Ekipi për Vlerësimin e Granteve (EVG), bazuar në këto kriteret:

- ✓ *Dizajnimi dhe zbatimi i një nisme të suksesshme (qasje, aktivitet, projekt, etj.) në promovimin dhe zhvillimin e demokracisë në Kosovë, gjatë vitit 2022;*
- ✓ *Natyra inovative e nismës;*
- ✓ *Ndikimi aktual ose i pritur i kësaj nisme, duke përfshirë potencialin për zgjerim/përsëritje;*
- ✓ *Guximi i organizatës a individit shprehur përmes nismës në fjalë;*
- ✓ *Përfshirja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në iniciativë ose kontribut i jashtëzakonshëm i pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike dhe/ose politikëbërje.*

Procesi i nominimit

Për të kompletuar procesin e nominimit, sigurohuni që keni plotësuar dhe dorëzuar dokumentet vijuese:

1. Formularin për nominim të plotësuar;
2. Dokumentet përcjellëse (artikuj të shkruar dhe referenca për të nominuarin/en, etj.);
3. Për organizata jo-qeveritare, një kopje të certifikatës së regjistrimit; Për nismat qytetare një dëshmi mbi funksionimin e nismës². (*Dokumentet duhet të jenë të subjekteve të nominuara, jo të nominuesve*).

Dorëzimi i dokumentacionit

Formulari për nominim së bashku me dokumentet plotësuese duhet të dërgohen në formë elektronike në formatin Word ose PDF në aja@kcsfoundation.org jo më vonë se **20.01.2023, ora 16:00**.

Nominimet e dorëzuara pas datës 20.01.2023 nuk do të shqyrtohen.

Kjo thirrje për nominime nuk parasheh ofrimin e përgjigjeve individuale dhe dhënien e arsytimit për nominimet që nuk përzgjidhen. Nominuesit e suksesshëm do të njoftohen për vendimin pas vlerësimit të plotë të nominimit. Gjatë procesit të vlerësimit palët nuk duhet të kontaktojnë KCSF-në mbi statusin e nominimit të tyre.

² Çfarëdo dokumenti që dëshmon ekzistencën e nismës p.sh: lista e anëtarëve, foto, materiale nga aktivitetet/takimet etj.